

---

**Lënda:** Informacion i pjesshëm në lidhje me inspektimin e objekteve të financuara nga Bashkia Tiranë për periudhën kohore nga viti 2012 deri në vitin 2018.

**Objekti:** Rikualifikim Urban i Bllokut 34/1, Tiranë

**Investitori:** Bashkia Tiranë

**Vlera e Investimit:** 36,236,957 lekë

**Periudha kohore:** Tetor 2012, deri në qershor 2013

**Inspektimi është kryer:** Dhjetor 2018

Ky objekt është zbatuar brenda Unazës së qytetit të Tiranës, në një bllok banimi pranë zonës së Medreses së Tiranës. Blloku i banimit (shënuar në investim si blloku 34/1) kufizohet me bllokun e banimit të formuar nga "Rruga e Dibrës", rruga "Ferit Xhajko" dhe rruga "5 Maji", me një sipërfaqe të përgjithshme të këtij blloku banimi me rreth 18,000 m<sup>2</sup> (sipërfaqja përfshin ndërtesa, rrugë, trotuare, sipërfaqe të gjelbëruar). Gjendja ekzistuese e infrastrukturës së bllokut të banimit në momentin e investimit ka qenë e amortizuar.

Projekti ka ndërhyrë në rikualifikimin urban të gjithë këtij blloku banimi, duke përfshirë, rikonstruksionin e shtresave rrugore të rrugëve të brendshme rreth ndërtesave (shtrimi me "binder" dhe shtrimin me asfalt të tyre), në rehabilitimin e plotë të shtresave të dëmtuara të trupit të rrugëve të brendshme, me të gjitha komponentët e saj (stabilizanti plus nënshtresat e tjera), në rehabilitimin e rrjetit të ujërave të bardha dhe të zeza, në rikonstruksionin e tubacionit të ujit të pijshëm, me rikonstruksionin e të gjitha pusetave të ujërave të bardha e të zeza, në sistemimin e plotë të trotuareve, bordurave anësore të rrugëve, në rehabilitimin e rrjetit të ndriçimit, në sinjalistikë rrugore, sistemim dhe gjelbërim, etj. Projekti i zbatimit ka parashikuar një rehabilitim të përgjithshëm të këtij blloku banimi. Është një zonë e vjetër banimi, kryesisht me pallate katër e pesë katësh dhe me infrastrukturë të rregulluar që nga koha e ndërtimit të tyre, por që në momentin e investimit ka qenë e nevojshme ndërhyrja për rehabilitimin e saj për shkak të amortizimit të madh.

Punimet kanë filluar rreth muajit tetor të vitit 2012 dhe kanë perfunduar në muajin qershor 2013, që përkon edhe me përfundimin e deklaruar nga Bashkia Tiranë. Investimi është kryer në periudhë fushate zgjedhore (zgjedhjet parlamentare të vitit 2013). Afati i garancisë së punimeve për objektin ka përfunduar (afati për këtë objekt ka qenë dy vjet). Është kryer në favor të firmës zbatuese të punimeve edhe zhbllokimi i garancisë së punimeve prej 5 % të vlerës së situacionit përfundimtar. Gjithashtu duhet të përmendim se zbatimi i punimeve për këtë bllok banimi është bërë në kushte optimale, pasi rrugët gjatë periudhës së rikonstruksionit kanë qenë pothuajse të bllokuara. Edhe pse objekti ka vetëm disa vite që është perfunduar, cilesia e zërave kryesorë të punimeve lë për të dëshiruar. Sipas manualit të punimeve të ndërtimeve edhe pse garancia e punimeve zgjat vetëm dy vjet, jetëgjatësia e këtyre investimeve do duhet të shkojë përtej një periudhe kohore prej 8 deri në 12 vite. Theksojmë këtu se është bllok banimi vetëm me trafik të brendshëm, për banorët e tij.

## Nga pamja vizuale e objektit konstatojme se:

- Trupi i rrugës ka lëvizje (ulje) dhe plasaritje të shtresave të asfaltit (në vendet ku janë hapur gropa dhe shtresat e asfaltit janë më të dukshme. Trashësia e shtresave të asfaltit është shumë e vogël)
- Ka sipërfaqe të shtresave të asfaltit, të cilat kanë filluar që të therrmohen (gjë që tregon se shtresa e asfaltit të hedhur nuk është material cilësor dhe sipas standardeve);



Fig 1

Ka demtime te shumta ne asfalt per shkak te cilsise se dobet te shtresave asfaltike

- Vihen re ulje të trotuareve dhe thyerje të pllakave të tyre;
- Edhe pse është detyrim ligjor i bashkisë lirimi i hapësirave publike të zëna forcërisht nga banorët, në këtë bllok banimi janë të dukshme objektet e ndërtuara pothuajse brenda

trupit të rrugëve ekzistuese të brendshme, të këtij blloku banimi;

- Trotuaret anësore të rrugës janë variabël (diku është 1.2 m diku 0.8 m dhe diku vetëm bordura anësore e rrugës);
- Nuk janë respektuar sipas standardit të kërkuar lidhja e trotuareve me trupin e rrugës për personat me aftësi të kufizuara (ato pothuajse mungojnë fare);

Fig 2

Ka puseta te demtuara e vendosura jo ne nivel te njetrajtshem me trupit e rruges (me parete anesore te tyre





- Pusetat e grumbullimit të ujërave të bardha (ujërat e shiut) nuk janë vendosur në kuotat e duhura dhe seksioni i tubave të tyre është shumë i vogël, për të përballuar qoftë edhe reshje minimale shiu. Ka puseta të ujërave të shiut të cilat rezultojnë pothuajse të mbushura me materiale inerte dhe pothuajse nuk funksionojnë. Pas çdo reshje shiu (flasim edhe për reshje me intensitet minimal), i gjithë blloku i rrugëve para pallateve të banimit pranë rrugës “Ferit Xhajko” rezulton i përmbytur.



Fig 3

Pllakat e shtruara ne shume raste kane levizur vendit duke humbur nivel dhe duke u shkenutur nga teresia e

Herë pas here punonjësit e mirëmbajtjes së Bashkisë Tiranë janë paraqitur për pastrimin e pusetave të ujërave të shiut, por zgjidhja e dhënë nga zbatuesi i punimeve për këtë bllok banimi për kanalizimet e ujërave të bardha ka rezultuar i dështuar.




Fig 4

Per shkak te mosfunktionimit te pusetave te shkarkimit te ujrave te shirave, nje pjese e ambjenteve te banimit peson permbytje te vazhdueshme. Kjo permbytje con ne depozitimin e materialeve inerte dhe mbeturinave te percjella nga ujrat e shirave, te cilat gjate sezonit te thate kthehen ne rrezik per banoret e zones

Fig 5

Rikonstruksioni i shkalleve lidhese te dy niveleve te bllokut te banimit eshte kryer duke perdorur material te dobeta ndertimi, çka çuar ne demtimin e pothuajse teresishem te ketyre shkalleve nga perdorimi i banoreve dhe ujrat rrjedhese



Bashkia Tiranë si Investitore e këtij objekti, nuk ka zbatuar detyrimet ligjore të saj, duke ç'bllokuar garancinë e punimeve, edhe pse në trupin e rrugës ka patur ulje të konsiderueshme, pothuajse brenda afatit të garancisë së punimeve. Defektet e shfaqura, i janë bërë prezente specialistëve të Bashkisë Tiranë, pothuajse menjëherë pas inagurimit të kësaj vepre. Firma zbatuese e punimeve do duhej në mënyrë të menjëhershme të ndërhynte me fondet e veta, për riparimin e menjëhershëm të tyre, pa pritur degradimin e mëtejshëm të saj, apo përfundimin e garancisë së punimeve të objektit (fondi i garancisë së objektit është 5% e vlerës së situacionit përfundimtar). Janë raste shumë të vogla për të mos thënë asnjë rast, kur Bashkia Tiranë të ketë marrë vendimarrje ndaj firmave të zbatimit, investimet e të cilave kanë rezultuar me mangësi të theksuar të cilësisë të zbatimit të tyre.



Fig 6

Zgjidhje rrethore e banoreve te zones per ti bere balle mungeses se pusetave te ujrave te bardha dhe permytjeve ne sezonin e dimrit

---

**Konkluzionë në lidhje me objektin:**

- *Do duhen të riparohen të gjitha uljet e shtresave të asfaltit të trupit të rrugëve dhe aty ku dukshëm asfalti rezulton i "gripuar" (dëmtuar) të rishtrohet e gjithë shtresa e asfaltit;*
- *Të bëhet riparimi i pllakave të parapërgatitura të trotuareve, duke zëvendësuar të gjitha pllakat e thyera në to;*
- *Të riparohen të gjitha kalimet për personat me aftësi të kufizuara në trotuare për lidhje të njëtrajtëshme të tyre me trupin e rrugës, e pa pengesa;*
- *Të bëhet riparimi i plotë i të gjitha pusetave të ujërave të bardha e të zeza dhe dhënia e pjerrësisë së domosdoshme për shkarkimin e këtyre ujërave;*
- *Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit do duhet të shikohen dhe kontrollohen me rigorozitet të gjitha investimet e kryera në fushata zgjedhore, pasi në shumicën e rasteve këto investime kanë rezultuar me problematika të shumta;*
- *Sipas mendimit tonë, vlera për riparimin e defekteve të vërejtura mendojmë se zënë jo më shumë se 25 deri në 30 % të vlerës së situacionit përfundimtar.*

Për të gjitha vërejtjet e mësipërme jemi mbështetur në nenet e praktikave standarde të kontratave të zbatimit të punimeve, si edhe në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.01.2001, nr. 2, datë 13.05.2005 dhe nr. 1, datë 16.06.2011, "Për mbikëqyerjen dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit".